

UNESCO, SHQIPËRIA DHE TRASHËGIMIA SHPIRTËRORE

Në kuadrin e 60 - vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në UNESCO

Në krye të herës, ajo që ka bërë UNESCO për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore shpirtërore në nivel ndërkombëtar dhe të shteteve anëtare është e jashtëzakonshme, dhe për të mund të flitet si për një evolucion. Kjo sjellje institucionale e saj ka konsistuar në dy drejtime:

Së pari, në miratimet e standardeve ligjore për ruajtjen e kësaj trashëgimie, kam parasysh konventën vizionare të vitit 2003 “Për ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore” si dhe atë të vitit 2005 “Për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore”. Konventa e parë, një ndër më të rëndësishmet e UNESCO-s për 15 vitet e fundit, përfshin në vetvete dhe i referohet instrumenteve ndërkombëtare ekzistuese lidhur me të drejtat e njeriut, në veçanti deklaratës së përbotshme për të drejtat e njeriut të 1948-s, paktit ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të 1966-s si edhe paktit ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike të 1966-s. Konventa, duke marrë parasysh rëndësinë e trashëgimisë kulturore shpirtërore, përmbledhëse e diversitetit kulturor dhe garanci e zhvillimit afatgjatë, duke marrë parasysh ndërvarësinë midis trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe trashëgimisë materiale kulturore dhe natyrore, pranon se proceset e globalizimit dhe të ndryshimit shoqëror, krahas kushteve që krijojnë për një dialog të përtërirë mes bashkësive, shkaktojnë edhe dukuritë e mostolerancës, kërcënime të rënda për degradim, për zhdukje dhe shkatërrim të trashëgimisë kulturore shpirtërore, veçanërisht për faktin e mungesës së mjeteve për ruajtjen e kësaj të fundit.

Së dyti, në peshën që i dha trashëgimisë shpirtërore, e posaçërisht njeriut si bartës të saj, duke e vendosur atë në qendër të këtij kujdesi institucional, pas viteve të tëra të mbrojtjes së trashëgimisë materiale të njeriut dhe jo të vetë atij, pra, të njeriut si krijues dhe gjenerues i këtyre vlerave. Konventa vlerëson vullnetin e përbotshëm dhe shqetësimin e përbashkët për të ruajtur trashëgiminë kulturore shpirtërore të njerëzimit, duke pranuar se bashkësitë, në veçanti bashkësitë rrënjëse, grupet dhe, sipas rastit, individët, luajnë një rol të rëndësishëm në prodhimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe rikrijimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore, çka ndihmon për pasurimin e diversitetit kulturor dhe të krijimtarisë njerëzore.

Realitetit të ri, të krijuar nga konventa e vitit 2003, Shqipëria iu *“përgjigj flakë për flakë”*. Hapi i parë ishte në përfshirjen për të parën herë të konceptit *“trashëgimi shpirtërore”* në ligjin nr. 9048 *“Për trashëgiminë kulturore”*, i cili u hartua dhe u aprovua po në vitin 2003 me ekspertizën e ngushtë të UNESCO-s dhe të Këshillit të Evropës. Lëvizja tjetër e radhës ishte nisja e aplikimit për kandidimin e polifonisë me iso, që u finalizua me sukses më 25 nëntor 2005, duke e regjistruar këtë dukuri unike dhe Shqipërinë si origjinën e saj edhe si themelues të *“Listës përfaqësuese të dukurive shpirtërore”* të UNESCO-s, e po atë vit edhe regjistrimi në *“Kujtesën e botës”* nga UNESCO të Kodikut të Purpurt të Beratit.

Futja e konceptit *“trashëgimi shpirtërore”* dhe zgjerimi i tipologjive të saj që fillonin me gjuhën, folklorin, dihebërjen, artet e shfaqjes etj., solli një realitet të ri mbrojtjeje të trashëgimisë kulturore në Shqipëri, e cila siç dihet kishte traditë kryesisht në mbrojtjen e trashëgimisë materiale. Sigurisht progresi u bë dalëngadalë, sepse pati rezistencë nga moskuptimi, por edhe nga mungesa e kapaciteteve që duhen me domosdo për implementimin e standardeve të reja. Regjistrimi i polifonisë me iso, si mënyrë e të bërit muzikë dhe jo thjesht si krijime të veçanta, mundësoi që harta e kësaj dukurie të përfshinte gjithë jugun e Shqipërisë dhe me dhjetëra e qindra tipologji ku polifonia me iso është baza e ekzistencës së tyre. Kjo bëri që të shmangnim shpalljen një e nga një të tipeve të veçanta, duke fituar kohë dhe energji që do të shpenzoheshin për një rrugë më të gjatë të konfirmimit të kësaj vlere të padiskutueshme. Të njëjtën praktikë ndoqëm në ato vite kur punoja si drejtor i Drejtorisë së Trashëgimisë Kulturore në

Ministrinë e Kulturës, edhe për regjistrimin në “World Heritage List” të UNESCO-s, për shpalljen “in situ” si monumente në grup, të qyteteve-muze të Gjirokastrës në vitin 2006 dhe të Beratit në vitin 2007, duke i përfshirë në një kandidatim të vetëm, pra me një shpallje, të gjithë larminë e trashëgimisë materiale që ata përfaqësonin e përfaqësojnë.

Duke u kthyer te polifonia me iso, e cila ka në thelb të kënduarit së bashku, pra në grup, theksojmë se ajo është një tregues i fuqishëm i jetës në bashkësinë njerëzore, tregues i nivelit të demokracisë dhe shoqërizimit të njeriut nga kohët e vjetra e deri më sot. Antropologët kanë nxjerrë në pah gjithashtu se një disiplinim i tillë demokratik, njerëzor dhe moral i familjes dhe i popullsisë shpjegon se përse demokracia asokohe arriti kulmin, edhe për arsye sepse Shqipëria e sotme ka qenë e zgjedhur si një vend i parapëlqyer për jetën njerëzore prej kohës së vendbanimeve neolitike. Pikërisht këtu vërejmë funksionimin e familjes si një ansambël demokratik dhe të korit muzikor iso-polifonik (që kërcen, vajton dhe flet), si në një familje muzikore. Këtu sjellim ndërmend se përfshirja e polifonisë me iso në listën e UNESCO-s, krijoi një realitet të ri sjelljeje të gjithë aktorëve dhe faktorëve brenda vendit për nga trashëgimia shpirtërore në përgjithësi, si dhe ndaj iso-polifonisë në veçanti.

Faktikisht, prej vitit 2005, një seri masash janë marrë për ruajtjen, transmetimin, katalogimin dhe studimin e iso-polifonisë shqiptare.

Ndër to, përmendim:

1. Masat ligjore për mbrojtjen e iso-polifonisë, si: Aprovimi i aksion planit për ruajtjen e iso-polifonisë nga Ministria e Kulturës së Shqipërisë, në vitin 2005; Nxjerrja e Udhëzimit për ruajtjen e iso-polifonisë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) në vitin 2005.
2. Transmetimi i iso-polifonisë përmes futjes së iso-polifonisë në kurrikulat shkollore për edukimin e nxënësve me vlerat e trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe të diversitetit kulturor.
- 2.1 Ndërtimi i projekteve kulturore në fushën e trashëgimisë shpirtërore që nxisin transmetimin e iso-polifonisë si projekti: “Odat e iso-polifonisë” në vitet 2007-2009, me

- mbështetjen e UNESCO-s dhe të qeverisë së Japonisë, projekt i zhvilluar në katër qytete të Shqipërisë së Jugut, ku bartës të shquar të iso-polifonisë përcollën mënyrat e të kënduarit dhe të interpretimit të iso-polifonisë të fëmijët; “Iso-polifonia e Himarës”, projekt i mbështetur financiarisht nga UNESCO-BRESCHIE për realizimin e një CD-je dhe programi televiziv me muzikë iso-polifonike; prodhimi dhe shfaqja e filmave të ndryshëm dokumentarë kushtuar iso-polifonisë dhe bartësve të saj me financim të MTKRS-së, së Qendrës Kombëtare të Kinematografisë dhe të Radio-Televizionit Publik Shqiptar etj.
3. Organizimi i aktiviteteve kombëtare kushtuar tipologjive dhe gjinive muzikore të iso-polifonisë, si: “Festivali i sazeve”, i cili mbahet në qytetin e Korçës, çdo vit, i organizuar nga MTKRS-ja dhe bashkia e qytetit të Korçës; “Festivali i iso-polifonisë”, që mbahet çdo vit në qytetin e Vlorës, i organizuar nga Bashkia e Vlorës si dhe shumë veprimtari të organizuara nga institucione private ose shtetërore në nivel vendor, si: “Përmeti multikulturor”, Përmet, “Bylisfonia”, Mallakastër, “Sofra ilire”, Fier, “Festivali i këngës dhe i valles çame”, Sarandë etj.
 4. Studimi i iso-polifonisë dhe botimet kushtuar asaj, si p.sh: Botimi i “Enciklopedisë së iso-polifonisë shqip-anglisht”, me mbështetjen e fondit të ambasadorit amerikan për trashëgiminë kulturore në vitin 2007, i realizuar nga Këshilli i Muzikës Shqiptare etj.
 5. Katalogimi i iso-polifonisë, u plotësua me të dhëna për iso-polifoninë, që është i shfrytëzueshëm edhe online në faqen zyrtare të iso-polifonisë shqiptare www.isopolifonia.com prej muajit mars 2012. Ky sistem të dhënash u mundësua nga UNESCO me iniciativën e Këshillit të Muzikës Shqiptare, anëtar i Këshillit Ndërkombëtar të Muzikës (IMC).

Ky kujdes ndaj saj, është gërshetuar me mbrojtjen e trashëgimisë sonë në nivel kombëtar, duke pasur parasysh se trashëgimia kulturore në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht trashëgimia shpirtërore dhe gjuha shqipe si vektor i saj është e garantuar ligjërisht dhe drejtpërsëdrejti më së pari nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 3, ku thuhet: “... identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kombëtare... shteti ka për detyrë t’i respektojë

dhe t'i mbrojtë". Krahas saj, në Ligjin organik nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore", në nenin 1 sanksionohet konkretisht kjo mbrojtje, e posaçërisht zgjerohet kuptimi dhe niveli i mbrojtjes për trashëgiminë shpirtërore në kapitull të veçantë. Krahas hartimit dhe aprovimit të legjislacionit tjetër kombëtar, si të Ligjit nr. 70/2016, datë 30.6.2016, "Për zejtarinë në Republikën e Shqipërisë" apo të Ligjit nr. 96/2017 "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë", shteti shqiptar ka ratifikuar dy konventat bazë të UNESCO-s në këtë fushë "Për ruajtjen e trashëgimisë kulturore shpirtërore" në vitin 2003, dhe "Për mbrojtjen dhe zhvillimin e larmisë së shprehjeve kulturore", të cilat zbatohen në vendin tonë.

Pavarësisht ekzistencës së bazës ligjore, deri më sot, në Shqipëri ende nuk kemi një dokument të aprovuar zyrtarisht që trajton strategjinë dhe politikën e fushës së trashëgimisë kulturore. Gjithsesi, në këtë drejtim, po punohet, në mënyrë që të ketë një strategji kuadër të fushës së artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore së bashku. Një draftstrategji për trashëgiminë shpirtërore është hartuar me konsulencën e UNDP-së në vitin 2010, e cila mund të shërbejë si bazë nëse përfshihet në dokumentin e ri të strategjisë kombëtare në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Hap tjetër i rëndësishëm për institucionalizimin e mbrojtjes së trashëgimisë shpirtërore në Shqipëri ishte aprovimi i "Listës kombëtare të kryeveprave të trashëgimisë kulturore shpirtërore".¹⁷

¹⁷ Lista përbëhet nga këto elemente dhe dukuri shpirtërore: "Isopolifonia popullore shqiptare", pjesë e "Listës përfaqësuese të trashëgimisë kulturore shpirtërore - UNESCO"; Folklor vokal, instrumental dhe koreografik, tipologji të trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare. IP është dukuria bazë muzikore në Shqipërinë e Jugut, e cila ndërtohet mbi parimin e këndimit të një apo disa zërave të ndryshëm solistikë, mbi një shtrat isoje të kënduar nga një grup këngëtarësh. Tiptet kryesore janë iso-polifonia labe, iso-polifonia toske dhe iso-polifonia çame. Iso-polifonia është 2-3 dhe 4 zërëshe: vokale, instrumentale dhe koreografike. "Eposi i kreshnikëve" - Folklor vokal, instrumental dhe koreografik, tipologji të trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare. Cikël këngësh legjendare, i shoqëruar me lahutë, me në qendër dy vëllezërit, Muji dhe Halili, që këndohet në Shqipërinë e Veriut. Koha e formimit të tij lokalizohet të jetë përpara dyndjes sllave në Ballkan, pra parasllav dhe paraturk. Për shumë studiues të "Eposit të kreshnikëve", vlera e tij krahasohet me eposin homerik, sagat e Skandinavisë, Kalevalën, Nilinat ruse etj. Eposi është kënduar vetëm në odat e miqve, kuvendet

Krijimi i saj u iniciua nga fryma e konventës së vitit 2003 dhe u ligjëruea përmes Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, "Për trashëgiminë kulturore", neni 6, pika 2. Aktualisht, me ligjin e ri, krahas kësaj liste kemi edhe listën e dukurive shpirtërore në rrezik, që është një tjetër nivel kujdesi ndaj kësaj trashëgimie. Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Shpirtërore i propozoi në mbledhjen e datës 28 shtator 2010, ministrit të Kulturës "Listën e kryeveprave të trashëgimisë kulturore shpirtërore", e përbërë fillimisht nga 7 dukuri, ndër më përfaqësueset në lëmin e trashëgimisë sonë shpirtërore. Pjesë kësaj liste është edhe një dukuri e minoritetit grek në Shqipëri, listë e përditësuar edhe me "Kcimin e Tropojës", i shpallur si pjesë e saj në vitin 2018.

e burrave si dhe në festa të ndryshme, pa stimuj materialë për rapsodët. Nga shumë studiues janë vënë re ngjashmëritë e eposit tonë me poemat homerike. **"Dialektet gjuhësore"**: dialekti gegë dhe ai toskë - Folklor gojor, tipologji e trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare. Mbështetur në ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 "Për trashëgiminë kulturore", folklori gojor është teksti i krijimit popullor, i pashoqëruar me muzikë, i cili lexohet ose tregohet. **"Muzika popullore qytetare homofonike e Shqipërisë së Mesme"** - Folklor vokal, instrumental dhe koreografik. Tipologji të trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare. **"Ahengu qytetar shkodran"** - Folklor vokal, instrumental dhe koreografik, tipologji të trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare. Ahengu shkodran është pjesë e rëndësishme e repertorit të muzikës popullore të qyteteve shqiptare të gegërisë. Ahengu organizohet në "perde" - shkallë muzikore specifike, të cilat janë dymbëdhjetë gjithsej. Ahengu fillon të kristalizohet aty nga fillimi i shek. XVIII dhe bëhet natën e dasmës, ditën e martesës, mbrëmjen e kurorës, deri në mëngjesin e ditës së nesërme. Ahengu shoqërohet nga formacioni i përbërë nga vegla popullore si dhe ato të importuara. I shprehuri melodik i ahengut është monodik, si dhe monodi me shoqërim. **"Mjeshtëria e punimit të veglave muzikore popullore"** - Zeje tradicionale, pjesë e trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare. Mjeshtëria e punimit të veglave muzikore popullore përbën një zeje të veçantë në pamjen e përgjithshme të zejtarisë shqiptare. Deri në momentin kur filluan të hapen dyqanet e para të punimit të veglave (gjysma e dytë e shek. XIX, fillimi i shek. XX), veglat muzikore popullore punoheshin vetë prej çdo familjeje dhe në veçanti prej bartësve të folklorit. Në rrugë artizanale, në Shqipëri kanë qenë prodhuar dhe ende prodhohen vegla, si: gajde, fyelli, culë dyjare, çifteli, sharki, lahutë, dajre, daulle, lauri, buzuk, bakllama, llahutë etj. Profilizimi i ngushtë i mjeshtrove të prodhimit të veglave, u formua rreth fillimit të shek. XX. Mbas çlirimit të Shqipërisë, në vitin 1944, në Tiranë u ngrit edhe një repart që prodhonte vegla muzikore popullore për nevojat e shtëpive të kulturës nëpër rrethe. **"Vallja e vajzave dropullite"** - Folklor instrumental dhe koreografik, tipologji e trashëgimisë shpirtërore të minoritetit etnik grek, pjesë e diversitetit kulturor në Shqipëri.

Prej 10 vitesh kryen funksionet e tij në mbrojtje të trashëgimisë shpirtërore, Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore (KKTKSH), organi më i lartë i trashëgimisë kulturore shpirtërore në Shqipëri që kryesohet nga ministri i Kulturës.

KKTKSH-ja dhe përbërja e tij institucionale vendoset me Vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithë veprimtaria e KKTKSH-së bazohet në Ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, në aktet ligjore e nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore materiale e shpirtërore si dhe të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. KKTKSH-ja në veprimtarinë e saj zbaton politikën e qeverisë së Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore shpirtërore dhe është vendimmarrës për të gjitha çështjet që lidhen me fushën e trashëgimisë kulturore shpirtërore. KKTKSH-ja për kryerjen e veprimtarisë së tij, bashkërendon punën me institucionet kulturore artistike dhe shkencore në vend, me pushtetin vendor, me bashkitë dhe komunat, shoqatat kulturore artistike dhe individët që merren me trashëgiminë shpirtërore. Ai bashkëpunon dhe mbikëqyr veprimtarinë e të gjitha institucioneve të trashëgimisë kulturore shpirtërore, harton programet e zhvillimit në këtë fushë, përgatit projekt akte nënligjore dhe propozon përmirësime ligjore në fushën e trashëgimisë shpirtërore.

Janë disa veprimtari kombëtare dhe mbarëkombëtare që përshtet kujdesin e drejtpërdrejtë institucional të shtetit shqiptar në mbrojtjen e trashëgimisë shpirtërore:

Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës (FFK)

Festivali Folklorik Kombëtar është aktiviteti më i rëndësishëm në fushën e trashëgimisë kulturore shpirtërore mbarëkombëtare shqiptare që ruan dhe promovon vlerat e trashëgimisë shpirtërore shqiptare në fushën e folklorit muzikor vokal, instrumental, të valles, riteve dhe arteve të shfaqjes. Në këtë festival marrin pjesë grupet përfaqësuese të 12 qarqeve të Shqipërisë dhe përshëndesin grupet folklorike të shqiptarëve nga Republika e Kosovës, Republika e Maqedonisë, Mali i Zi, arbëreshët e Italisë dhe grupet e tjera nga diaspora shqiptare në botë. Megjithëse FFK janë zhvilluar edhe më përpara, FFK-të që mbajnë emrin e qytetit organizator të tij, qytetit-muze të Gjirokastrës që është “Pasuri kulturore e njerëzimit”, nga

UNESCO, janë festivalet që krijuan traditën e këtij lloj aktiviteti në Shqipëri në vitin 1968. Aktualisht, bashkë me UNESCO-n edhe festivali ynë këtë vit mbush 60 - vjetorin e themelimit dhe për këtë festival, Ministria e Kulturës dhe Akademia e Artit dhe Trashëgimisë ODEA po synojnë regjistrimin e tij në praktikën më të mira të mbrojtjes së trashëgimisë shpirtërore të UNESCO-s.

Festivalet Folklorike Tipologjike Kombëtare

Paketa e projekteve kombëtare vjetore të trashëgimisë kulturore shpirtërore nën emërtimin "Festivalet Folklorike Tipologjike Kombëtare" është një tjetër realitet për mbrojtjen, ruajtjen dhe popullarizimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore në Shqipërinë e pas viteve 1990. Në kuadër të shndërrimeve të përgjithshme që përfshinë gjithë jetën e vendit pas viteve 1990 dhe të ndryshimeve të përgjithshme të politikës kulturore të shtetit përkrah trashëgimisë kulturore shpirtërore, folklorit muzikor dhe traditave kulturore në përgjithësi, u vu re një përkujdesje që synonte ruajtjen dhe mbrojtjen e saj të inspiruar nga rekomandimet e UNESCO-s për mbrojtjen e folklorit të vitit 1989. P.sh., për të parën herë në historinë e trashëgimisë kulturore shpirtërore në Shqipëri, u organizua në vitin 1994 në qytetin e Korçës "Takimi kombëtar i sazeve dhe orkestrinave popullore të Jugut". Veprimtaria në fjalë "shkëputi" nga masa e gjerë dhe e shumëllojshme e tipologjive të folklorit tonë muzikor njërën prej veçorive të tij, atë të muzikës popullore qytetare me saze të Shqipërisë së Jugut. Kjo bëri të mundur jo vetëm çeljen e një dritareje të re në organizimin e veprimtarive, por rrëzoi edhe mendësinë dhe praktikën e ndjekur deri më atëherë në organizimet dhe paraqitjet tërësore të folklorit muzikor shqiptar. Këto festivale të përvitshme kushtuar sazeve, rapsodëve, iso-polifonisë, valleve etj., organizohen nga Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike (QKVF) në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave, Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit në Akademinë e Studimeve Albanologjike (ASA), Universitetin e Arteve si dhe nga organet e pushtetit vendor të bashkive respektive. Kjo veprimtari promovon dhe popullarizon tipologjitë kryesore të folklorit shqiptar, si: këngën, vallen, melodinë, instrumentet e kostumet popullore, si vlera të pamohueshme të krijuara prej shekujsh.

Inventarët e trashëgimisë kulturore shpirtërore

Nevoja për katalogimin e dukurive të trashëgimisë kulturore shpirtërore është ngushtësisht e lidhur sa me detyrimet ligjore të parashikuara në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, e po aq nga nevoja për ruajtjen e kësaj trashëgimie. Fillimet e katalogimit të kësaj trashëgimie lidhen me Urdhrin e ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr. 520, dt. 29.09.2010, “Për shpalljen kryevepra të trashëgimisë kulturore shpirtërore të krijimeve me vlera kulturore unikale”, në nenin 2:

“... ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore për katalogimin e “Kryeveprave të Trashëgimisë Kulturore”, sipas tipologjive dhe kartelave tip”.

Deri më tani, përvoja e vetme në Shqipëri lidhet me projektin e Këshillit të Muzikës Shqiptare, anëtar i International Music Council (IMC), projekt i mbështetur financiarisht nga UNESCO-ja në vitin 2011, për krijimin e “Inventarit online të iso-polifonisë shqiptare”. Në pikëpamjen e digjitalizimit të arkivave të trashëgimisë shpirtërore në Shqipëri, përvoja më e suksesshme lidhet me digjitalizimin e arkivit audiovizual të Institutit të Antropologjisë Kulturore, dhe të Studimit të Artit, në Akademinë e Studimeve Albanologjike (ASA). Aktualisht, një tjetër projekt i financuar nga UNESCO-ja po zbatohet nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore (DKTK)

Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore, është gjithashtu një aspekt tjetër i rëndësisë që në Shqipëri i kushtohet mbrojtjes dhe popullarizimit të trashëgimisë kulturore në përgjithësi dhe asaj shpirtërore në veçanti. Zyrtarizimi i kësaj dite, si e tillë, u bë me Urdhrin nr. 348, dt. 28.7.2003, “Për shpalljen e Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore”, të ministrit të MTKRS-së, i cili ka shpallur datën 29 shtator të çdo viti, si Ditën Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore. DKTK-ja ka një simbolikë te veçantë: e para, sepse kjo datë ka në thelb të saj rënien e veprimtarit të lëvizjes atdhetare, dëshmorit të monumenteve, Kamber Bënjës në vitin 1916; dhe se dyti, ajo zhvillohet paralelisht, në fund të

muajit shtator me aktivitetin “Ditë të Trashëgimisë Kulturore”, një aktivitet i cili kulmon fushatën e Këshillit të Evropës: “Europa, një trashëgimi e përbashkët”. Prej gati 15 vjetësh, kjo ditë po shndërrohet në një tribunë të ballafaqimit të vlerave të identitetit dhe diversitetit kulturor në Shqipëri, dhe në një moment reflektimi dhe konvergimi idesh dhe projektesh mbështetur memories dhe trashëgimisë sonë të përbashkët evropiane. Në këtë ditë, në Shqipëri, kujtojnë me respekt trashëgiminë e tyre kombëtare (materiale dhe shpirtërore), pjesë e trashëgimisë evropiane, kur të gjitha vlerat e saj materiale e shpirtërore bëhen një, së bashku me njerëzit që i krijuan ato dhe i ruajtën për t’ua përcjellë brezave si dëshmi e identitetit kulturor dhe evropian.

Përfundim

Ka ardhur koha që trashëgimia shpirtërore në Shqipëri të ripërmasohet në të gjitha aspektet, duke filluar nga politikat kulturore, nga vlera dhe rëndësia që ajo ka për identitetin tonë kulturor, edukimin përmes trashëgimisë dhe transmetimin e saj në brezat e rinj dhe posaçërisht në fushën studimore ndërdisiplinore.

Larmia dhe shumëllojshmëria në variante dhe tipe, përhapja në gjerësi dhe thellësi të territorit të vendit dhe vijueshmëria gjatë gjithë periudhave historike në të gjitha shtresat dhe grupet e popullsisë (shqiptare, greke, vllahe, maqedonase, rome etj.), vlerat njerëzore dhe demokratike të saj, bukuria artistike dhe simbolikat e pafundme të formave, të gjitha këto të bëjnë të mendosh, se më përpara se çdo lloj monumenti material, sado i vjetër qoftë ky, është vetë njeriu (me gjuhën dhe dialektet, ritualet, folklorin gojor, muzikor dhe koreografik, veglat muzikore, veshjet, mjetet e jetesës etj.), monumenti më i vjetër i botës.

Duhet të zgjerojmë hartën e UNESCO-s në veri të Shqipërisë, kjo si për trashëgiminë kulturore materiale e veçanërisht për atë shpirtërore, ku “Eposi i kreshnikëve” dhe “Kcimi i Tropojës” janë kandidatura të denja për t’u futur në procedurë ligjore për kandidim në listën e UNESCO-s!